

UDHËZIM
Nr.21, datë 18.9.2007

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.369, DATË 13.6.2007
“PËR FONDIN E VEÇANTË NË INSTITUCIONET BUXHETORE”

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.369, datë 13.6.2007 “Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore”, pika 5, Ministri i Financave,

UDHËZON:

1. Fondi i veçantë në institucionet buxhetore do të krijohet në masën 5% të fondit të planifikuar të pagave. Fondi i planifikuar i pagave, për efekt të llogaritjes së fondit të veçantë, do të përfshijë vetëm fondin e pagave të planifikuar për numrin e miratuar të punonjësve buxhetorë. Në këtë fond nuk përfshihen fondi i pagave që përdoret për punonjësit me kontratë, për punonjësit në listë pritje, për ushtarakët në reformë, punonjësit arsimorë në dispozicion, pagesa e bashkëshortëve të ushtarakëve, studentëve ushtarakë, punonjësve me kontratë të përkohshme etj.

2. Ky fond të përdoret nga drejtuesit e institucioneve për:

- Shpërblimin e punonjësve për rezultate të mira në punë;
- Shpërblimin e punonjësve në fund të vitit kalendarik;
- Shpërblime të tjera të parashikuara me akte të tjera ligjore apo nënligjore;
- Dhënie ndihmash të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera;
- Veprimtari social-kulturore.

3. Shpërblimi për rezultate të mira në punë gjatë vitit, për çdo punonjës, do të jetë i diferencuar, por nuk duhet të jetë më shumë se 1 (një) pagë mujore për person. Ky shpërblim, në ministrinë dhe institucionet qendrore, të cilat janë në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, jepet i diferencuar në bazë të rezultateve individuale në punë, sipas parimeve dhe procedurës së përcaktuar në legjislacionin e shërbimit civil dhe në përputhje me fondin e shpërblimit në dispozicion. Në institucionet buxhetore, të cilat nuk përfshihen në fushën e veprimit të ligjit të shërbimit civil, shpërblimi i punonjësve do të bëhet i diferencuar në bazë të performancës së punonjësit, por jo më shumë se 1 (një) pagë mujore për person. Edhe në rastet kur me ligje të veçanta masa e shpërblimit është më e madhe se një pagë mujore, ajo do të përballohet nga ky fond i veçantë.

4. Shpërblimi në fund të vitit i jepet çdo punonjësi buxhetor, për festat e fundvitit, në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë dhe përballohet nga fondin e veçantë.

5. Në ndihma të menjëhershme për raste fatkeqësish dhe raste të tjera përfshihen pagesat për:

- Rastet e vdekjes së punonjësit ose të një anëtarit të familjes së punonjësit (prindërit apo fëmijët), kur bashkëjetojnë. Pagesa jepet nga titullari i institucionit i diferencuar nga 10 000-30 000 lekë për çdo rast.

- Rastet e sëmundjeve të rënda të punonjësit, kur kërkohet një ndërhyrje shëndetësore jashtë vendit. Pagesa jepet nga titullari i institucionit, i diferencuar nga 30 000-50 000 lekë për çdo rast.

- Rastet e daljes së punonjësve në pension pleqërie. Pagesa jepet nga titullari i institucionit në masën e një page mujore.

6. Veprimtari e ndryshme, që kanë karakter social apo kulturor sikurse janë ato të organizuara për rastet e daljeve në pension, të festimeve të fundvitit, dhe të tjera organizime të realizuara nga institucioni, mund të përballohen nga fondin e veçantë.

Në këto veprimtari social-kulturore, kur ato organizohen jashtë qendrës së punës, shpenzimet e transportit dhe akomodimit paguhen nga vetë punonjësit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode